

VENDIM
Nr. 463, datë 3.7.2019

**PËR PËRCAKTIMIN E DREJTIMEVE PËR MIRATIMIN E STRATEGJIVE,
PROGRAMEVE DHE PLANEVE TË VEPRIMIT PËR PROMOVIMIN DHE
KRIJIMIN E KUSHTEVE TË NEVOJSHME PËR PERSONAT QË U PËRKASIN
PAKICAVE KOMBËTARE PËR TË PËRDORUR E ZHVILLUAR ELEMENTET
THEMELORE TË IDENTITETIT TË PAKICAVE KOMBËTARE, DUKE
PËRFSHIRË DHE GJUHËN E TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 12, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Kulturës dhe të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personat që u përkasin pakicave kombëtare gëzojnë të drejtën për ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit të tyre të dallueshëm në Republikën e Shqipërisë.

2. Ministria përgjegjëse në fushën e kulturës dhe ministria përgjegjëse në fushën e arsimit, sportit dhe rinisë kanë detyrimin për përcaktimin e drejttimeve për miratimin e strategjive, programeve e të planeve të veprimit për promovimin dhe krijimin e kushteve të nevojshme për personat, që u përkasin pakicave kombëtare për të përdorur e zhvilluar elementet themelore të identitetit të tyre.

3. Ministria përgjegjëse në fushën e kulturës dhe ministria përgjegjëse në fushën e arsimit, sportit dhe rinisë garantojnë mbrojtjen dhe promovimin e gjuhës së personave, që u përkasin pakicave kombëtare si një element përbërës të identitetit të tyre.

4. Ministria përgjegjëse për kulturën dhe institucionet në varësi të saj marrin masat për të krijuar kushtet e nevojshme për garantimin dhe ushtrimin e së drejtës së personave, që u përkasin pakicave kombëtare për ruajtjen e zhvillimin e identitetit të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor e fetar të tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

5. Ministria përgjegjëse për kulturën, në strategjinë për kulturën dhe në programin kombëtar “Edukimi përmes kulturës” parashikon dhe krijon kushtet e nevojshme për ruajtjen, promovimin, mbrojtjen, katalogimin e digjitalizimin për ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës e të identitetit të personave që u përkasin pakicave kombëtare si pasuri, vlerë dhe pjesë të trashëgimisë kulturore kombëtare dhe ndalimin e praktikave, që synojnë asimilimin e kulturës dhe të identitetit të tyre të dallueshëm.

6. Ministria përgjegjëse në fushën e arsimit, sportit dhe rinisë planifikon veprimtari të veçanta për institucionet publike të arsimit parauniversitar, me qëllim ruajtjen, promovimin, zhvillimin e kulturave, identitetin kulturor të dallueshëm dhe të gjuhëve të pakicave kombëtare.

7. Ministria përgjegjëse në fushën e arsimit, sportit dhe rinisë mbështet të rinjtë e organizatat rinore për organizimin e aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe promovuese për ruajtjen e zhvillimin e kulturave, të identitetit dhe të gjuhëve të pakicave kombëtare, si dhe ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore të pakicave kombëtare.

8. Ministria përgjegjëse në fushën e arsimit, sportit dhe rinisë dhe ministria përgjegjëse në fushën e kulturës promovojnë programe e projekte për ruajtjen dhe zhvillimin e kulturave, gjuhëve dhe elementeve kryesore të identitetit të personave që u përkasin pakicave kombëtare, zhvillimin e aktiviteteve në konsultim me ta dhe përfaqësuesit e tyre, bazuar në nevojat e grupeve të ndryshme dhe në përputhje me procedura transparente.

9. Kriteret dhe procedurat e pjesëmarrjes në projekte të ndryshme, ku aplikojnë përfaqësues të pakicave kombëtare janë të parashikuara në ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, të ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.

10. Personat që u përkasin pakicave kombëtare dhe përfaqësuesit e tyre ftohen të marrin pjesë në procesin e konsultimit gjatë hartimit dhe miratimit të strategjive, programeve dhe planeve të

veprimet për të krijuar kushtet e nevojshme që personat, të cilët u përkasin pakicave kombëtare të ruajnë dhe të zhvillojnë identitetin e tyre të dallueshëm në Republikën e Shqipërisë.

11. Burimet financiare për zbatimin e këtij vendimi do të mbulohen nga buxheti vjetor që parashikohet çdo vit për ministritë përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama